

VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT 17 MARS 2021

Vendimi Nr. 2021-13

Programi intensiv i ushtrimeve për National Teams

- Bordi me shumicë votash merr vendim që programi intensiv i ushtrimeve të vazhdojë, edhe në minimum për tre (3) kategori të tjera, specifikat e të cilave do të definoohen pas hartimit të planit të punës.
- Ky program do të aplikohet në 2021 ku me shumicë votash u emëruan të përfshihen trajnerët Shendrit Deari, selektorët, si dhe trajnerët tjerë të cilët do të ndërrohen me rotacion mujor.

Vendimi Nr. 2021-14

Emërimi i z. Shkëlzen Domi –Drejtor për Zhvillimin e tenisit në Kosovë

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin e Kryetari Jeton Hadërgjonaj për emërimin e z. Shkëlzen Dom në postin e Drejtorit për Zhvillim të tenisit në Kosovë.

Vendimi Nr. 2021-15

Angazhimi i trajnerit Enver Tahiraj dhe fizioterapeutit Zahir Rama në aktivitetet e FTK-së

- Bordi me shumicë votash merr vendim të fillojë bashkëpunimin në angazhimin e trajnerit kondicional Enver Tahiraj dhe fizioterapeutin Zahir Rama në aktivitetet e FTK-së të cilat priten të rriten gjatë mandatit 2021-2024 dhe detyrimisht nevojitet ngritje të kapaciteteve.

Vendimi Nr. 2021-16

Delegatët e FTK në kuvendin e KOK

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimet e Kryetarit Hadërgjonaj për pjesëmarrësit e delegatëve nga federata e tenisit në kuvendin e KOK që do të mbahet më 25 mars 2021.
- Delegatët e FTK-së për kuvendin zgjedhor në KOK do të jenë 1. Jeton Hadërgjonaj (Kryetar), 2. Blerina Mati (Nënkryetare), 3. Driton Latifi (Anëtar Bordi). Z. Latifi do të jetë i nominuar po ashtu për anëtar bordi në KOK.

Vendimi Nr. 2021-17

Konfirmimi i selektorëve për vitin 2021

- Bordi me shumicë votash riemëruan selektorët për vitin 2021 si në vijim:
 1. Granit Bajraliu- Selektor U16
 2. Arian Ibrahim- Selektor U14
 3. Lorik Haxhishabani- Selektor U12
- Ndryshime do të ketë në Kapitenin e Davis Cup, vendimi për të cilin do të merret ditëve në vijim, pas pranim të propozimeve edhe nga këshilli i trajnerëve.

Vendimi Nr. 2021-18

Angazhimi i një personi për marketing në FTK

- Bordi me shumicë votash merr vendim të hulumtohet dhe angazhohet një person i veçantë i/e cila do të jap kountribut në zhvillimin e marketingut të FTK-së dhe menaxhimin e rrjeteve sociale.

Vendimi Nr. 2021-19

Lansimi i Kampionatit Ekipor për femra dhe Kampionati Ekipor Shtetëror

- Miratohet me shumicë votash propozimi për lansimin e Kampionatit Ekipor për femra në vitin 2021.
- Miratohet me shumicë votash propozimi i anëtarit të bordit z. Driton Latifi për përfshirjen e kampionatit ekipor shtetërorë në kalendarin zyrtar të garave të FTK-së.

Vendimi Nr. 2021-20

Ritrajtimi i vendimeve të fundit të Komisionit Disiplinor

- a) Granit Bajraliu – Suspendohet nga pjesëmarrja si lojtar në turnet e federatës për një periudhë prej së paku 3 muaj;
- b) Durim Morina- I ndalohet pjesëmarrja në çfarëdo aktiviteti të FTK-së për së paku 4 muaj, respektivisht deri më 30 prill.
- c) Në rast të përsëritjes së veprave të tjera, dënimet do të jenë më të mëdha deri maksimale.

Vendimi Nr. 2021-021

Kutia e ndihmës së parë për klubet

- Bordi me shumicë votash merr vendim të pajisë të gjitha klubet me kutin e ndihmës së parë.
- Kërkesat e klubeve për rekuizita do të analizohen dhe përkrahen nga FTK sipas linjave buxhetore.

Vendimi Nr. 2021-22

Meçi i vajzave “Kalaja Juniors 2021 – U16

-Bordi me shumicë votash merr vendim që çështja dhe vendimi në lidhje me meçin final të vajzave në turneut “Kalaja Juniors 2021- U16” të i delegohet komisioneres së garave znj. Mërgime Mula.